



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 12/2019), Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në seancën e 83- të të mbajtur më 27.02.2023 miratoi,

### **Vendim**

Procedura për kontrollin e të dhënave për gjendjen pronësore nga fleta anketuese të \_\_\_\_\_ ministër në \_\_\_\_\_ të Qeveris së RMV-së, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së sipas lëndës me numër 08-4660/1 të datës 07.10.2019.

Lënda me numër 08-4660/1 të datës 07.10.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetimin në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e KSHPK-së në afat kohor prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

### **Arsyetim**

Lënda me numër 08-4660/1 datë 07.10.2019 është formuar me iniciativë të saj, bazuar në Planin Vjetor për monitorimin e gjendjes pronësore dhe interesave për vitin 2019.

KSHPK-ja nga i emëruari kërkoi informacion për anëtarët e familjes së saj me të cilët ajo jeton në një familje të përbashkët.

Të dhënat e kërkuara janë dhënë nga personi i përmendur.

Për të konstatuar gjendjen faktike në rastin konkret, KSHPK-ja ka marrë të dhëna për pasurinë e ----- dhe anëtarëve të familjes së saj nga Agjencia për kadastër të patundshmërive, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e të Ardhurave Publike, Depozita Qendrore e Letrave me Vlerë dhe Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KSHPK, nga të dhënat e marra nga institucionet e përmendura si dhe nga të dhënat nga fleta anketuese i dorëzuar nga i emëruari, konstaton se nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm kompetent në rastin konkret.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRORE  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Nënkryetar

**Katica Nikolovska**

